LIGJ
Nr. 78/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS ZVICERANE PËR PROJEKTIN "AFTËSI PËR PUNË", FAZA 2, 2019–2023

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për projektin "Aftësi për punë", faza 2, 2019–2023 sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.6.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13119, datë 28.6.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE
MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE KONFEDERATËS ZVICERANE, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM PËR PROJEKTIN "AFTËSI PËR PUNË", FAZA 2, 2019–2023

Në vijim të përpjekjeve për të fuqizuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë midis dy vendeve;

Marrëveshjes Kuadër për Bashkëpunimin Teknik dhe Financiar dhe Ndihmën Humanitare midis Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë Shqiptare, të nënshkruar më 11 maj 2007 dhe ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë si ligji nr. 9801, datë 13 shtator 2007,

dhe respektimit të parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut, të parashtruara veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të të dyja Palëve dhe përbën një element thelbësor së bashku me objektivat e kësaj Marrëveshjeje;

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane, kanë rënë dakord për termat dhe kushtet, si më poshtë vijojnë:

Neni 1
Dispozita të përgjithshme

Kudo që janë përdorur në këtë Marrëveshje, termat në vijim do të kenë kuptimet e mëposhtme, përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe:

a) "Palët Kontraktuese" nënkuptojnë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane;

b) "Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë" nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

c) "Konfederata Zvicerane" përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Departamentit Federal Zviceran i Punëve të Jashtme (SDC);

d) "Projekti" nënkupton projektin "Aftësi për punë", faza 2;

e) "Konfederata Zvicerane" nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme;

f) "Grant" nënkupton kontributin e dhënë nga Konfederata Zvicerane, sipas kësaj Marrëveshjeje;

g) "Partneri zbatues" nënkupton *Swisscontact*;

h) "AFP" nënkupton Arsimin dhe Formimin Profesional.

Neni 2
Përgjegjësia e Zbatimit

Përgjegjëse për zbatimin e Marrëveshjes janë autoritetet e mëposhtme: Për Konfederatën Zvicerane:

SDC-ja, përfaqësuar nga Ambasada e Zvicrës në Shqipëri.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

SDC-ja ia beson zbatimin e Projektit Partnerit Zbatues. Partneri Zbatues u përzgjodh në bazë të një procedure të hapur tenderi në fazën 1 të Projektit, të cilit i akordohet në mënyrë të drejtpërdrejtë faza 2, në përputhje me Udhëzimin Federal Zviceran për rregullat dhe rregulloret e prokurimit publik.

Neni 3
Qëllimet dhe objektivat

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është: Gratë dhe burrat në moshë të re nga të gjitha grupet sociale në Shqipëri të gjejnë mundësi të mira dhe fitimprurëse punësimi falë përmirësimit të aftësive.

Rezultatet specifike të këtij Projekti janë si vijon:

a) gratë dhe burrat në moshë të re kanë akses në ofertë arsimi dhe formimi që është e dobishme dhe e orientuar nga puna në sektorë me potencial zhvillimi;

b) sektori privat merr përsipër përgjegjësinë për përcaktimin, ofrimin dhe financimin e AFP-së në nivel ofruesi.

Për arritjen e këtyre objektivave, Projekti bashkëpunon me institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë, Agjencia Kombëtare e AFP-së, sektori privat dhe shoqatat e biznesit.

Ndërhyrjet, aktivitetet dhe rezultatet kryesore të parashikuara përcaktohen në dokumentin e Projektit. Përmbledhja e Dokumentit të Projektit është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje (shtojca 1).

Neni 4
Detyrimet e Palëve Kontraktuese

Detyrimet specifike të Konfederatës Zvicerane përfshijnë:

a) Deri më 30 gusht 2023, Konfederata Zvicerane synon të parashikojë fonde në formën e një granti të parimbursueshëm në vlerën maksimale prej CHF 9,600,000 (nëntë milion e gjashtëqind mijë franga zvicerane), i cili do të përdoret vetëm për zbatimin e Projektit, sipas qëllimeve dhe objektivave të përcaktuar më sipër në nenin 3 dhe Dokumentin e Projektit (shtojca 1).

b) Ky grant nuk mund të alokohet për asnjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e Grantit që do të mbetet në fund të Projektit, i kthehet Konfederatës Zvicerane;

c) Konfederata Zvicerane ka kontraktuar përmes SDC-së Partnerin Zbatues si organizatë zbatuese;

d) Granti do të disbursohet dhe auditohet, sipas dispozitave të kontratës midis SDC-së dhe Partnerit Zbatues.

Detyrimet specifike të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfshijnë:

a) Ministria e Financave dhe Ekonomisë vepron si bashkëpërgjegjëse për strategjinë e Projektit;

b) Sigurimi i bashkërendimit të Projektit me politikat kombëtare dhe kuadrin përkatës ligjor për të mundësuar dhe për të promovuar koherencën e objektivave të Projektit me kushtet e kuadrit kombëtar;

c) Mbështetja e lehtësimit dhe e ndarjes së përvojave dhe e informacioneve, bazuar në rezultatet e arritura dhe ndikimet e Projektit në nivel kombëtar;

d) Mbështetja dhe lehtësimi i ndërveprimit dhe i bashkëpunimit me ministritë dhe institucionet e tjera.

e) Sigurimi i përgjigjshmërisë dhe i bashkëpunimit të strukturave të decentralizuara në nivel rajonal dhe/ose lokal;

f) Vënia në dispozicion e buxhetit të nevojshëm për të kompensuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) të Projektit në një shumë maksimale prej 1'000'000 CHF (një milion franga zvicerane). Rimbursimet e TVSH-së bëhen me baza vjetore.

Neni 5
Menaxhimi i Projektit

a) Projekti është një nismë e përbashkët midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe SDC-së përmes Ambasadës së Zvicrës;

b) Partneri Zbatues merr përsipër në emër të Konfederatës Zvicerane të gjitha detyrat operacionale, administrative dhe mbikëqyrëse të Projektit, duke përshirë disbursimet, monitorimin dhe raportimin;

c) SDC-ja mund të autorizojë ekspertë vendës dhe të huaj në plan afatgjatë dhe afatshkurtër për të mbështetur zbatimin e Projektit;

d) SDC-ja mund të autorizojë individë të tjerë dhe organizata kombëtare ose ndërkombëtare për zbatimin e pjesëve të veçanta të Projektit si p.sh. për vlerësimin afatmesëm dhe vlerësimin përfundimtar të projektit;

e) Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të Projektit, ofron akses në informacione përkatëse, duke përfshirë të dhëna statistikore, të cilat konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit.

Neni 6
Mbikëqyrja dhe Koordinimi

Në mënyrë që të sigurohet mbikëqyrja, cilësia, përshtatshmëria dhe koordinimi i Projektit, si dhe adresimi i çështjeve të lidhura me politikat, ngrihet Komiteti Drejtues (KD), i cili parashikohet të mblidhet të paktën dy herë në vit (zakonisht në prill dhe shtator). Mund të organizohen mbledhje të paprogramuara, me kërkesë të njërit prej anëtarëve të KD-së. Mbledhjet kryesohen bashkërisht nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ambasada e Zvicrës në Shqipëri.

KD-ja e arrin kuorumin vetëm kur janë të pranishëm përfaqësuesit e të dyja Palëve. Vendimet merren me konsensusin e të gjithë anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote. Në qoftë se konsensusi nuk arrihet, fillohet një proces negocimi. SDC-ja gëzon te drejtën e marrjes së vendimit përfundimtar.

KD-ja përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfshirë agjencitë vartëse, bashkëkryetar (4 përfaqësues, 1 votë);
- Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, bashkëkryetar (2 përfaqësues, 1 votë);
- Përfaqësues të sektorit privat (4 përfaqësues, 1 votë);
- Ofruesit e AFP-së, mbështetur nga Projekti (2 përfaqësues me rotacion, 1 votë)

Në varësi të agjendës, institucionet e tjera (ministri të tjera, OJF dhe projekte të ngjashme) mund të bëhen pjesë e KD-së si vëzhgues me ftesë të bashkëkryetarit dhe pa të drejtë vote.

Sekretariati i Bordit Këshillimor ofrohet nga Projekti. Menaxheri i Projektit i Partnerit Zbatues merr pjesë në takim pa të drejtë vote.

KD-ja ndërmerr detyrat e mëposhtme:

a) Ofrimin e këshillimit strategjik, teknik dhe operacional; udhëzimeve dhe rekomandimeve të Projektit dhe Partnerit të tij Zbatues lidhur me fushat e ndërhyrjes së Projektit dhe instrumentet e qasjeve metodologjike;

b) Rishikimin dhe aprovimin e Planit Vjetor të Operacioneve të Projektit (PVO);

c) Këshillimin e Ekipit të Projektit mbi objektivat tematikë dhe gjeografikë për përdorimin e instrumenteve të Projektit, të informuara nga raportet monitoruese të Ekipit të Projektit.

d) Rishikimin e dokumenteve strategjike, raporteve dhe planeve vjetore, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme.

Palët Kontraktuese e informojnë në kohë njëra-tjetrën, në një shkallë të arsyeshme dhe praktike, si dhe konsultohen me njëra-tjetrën, lidhur me çdo ngjarje, që pengon apo mund të vështirësojë zbatimin e suksesshëm të Projektit.

Neni 7
Prokurimi i Mallrave dhe i Shërbimeve

a) Mallrat dhe shërbimet, që financohen nga produktet e kontributit zviceran prokurohen nga Partneri Zbatues, në përputhje me ligjin zviceran të prokurimeve. Organizata zbatuese është përgjegjëse për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve ndërtimore të nevojshme për

zbatimin e Projektit, duke respektuar parimet e konkurrencës së ndershme (të lirë dhe të drejtë) për të gjithë ofertuesit e mundshëm, në mënyrë që të sigurojë efikasitet në përdorimin e fondeve publike.

b) Gjatë kohëzgjatjes së Projektit, mallrat e ofruara me fondet e SDC-së për përdorim, në kuadër të Projektit, i vihen Projektit në dispozicion në mënyrë të pakufizuar dhe nuk devijohen nga Projekti pa miratimin paraprak me shkrim të SDC-së;

c) Nëse për ndonjë arsye Projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të ofruara përmes kontributit zviceran vendoset me shkrim nga Palët.

d) Në fund të Projektit, SDC-ja duhet të vendosë për pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruara gjatë zbatimit të Projektit;

e) Mallrat e prokuruara nga Projekti për organizatat partnere i dorëzohen dhe merren përsipër nga autoriteti kompetent përkatës me miratimin e SDC-së.

Neni 8

Zgjidhja e Marrëveshjes

a) Secila Palë ka të drejtë ta zgjidhë Marrëveshjen aktuale përmes një njoftimi me shkrim gjashtë muaj përpara përfundimit.

b) Nëse njëra nga Palët gjykon se qëllimet e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të arrihen më, ose që Pala tjetër nuk po përmbush detyrimet e saj, Pala tjetër ka të drejtën ta anulojë ose ta zgjidhë këtë Marrëveshje, duke bërë një njoftim me shkrim tre muaj përpara. Pavarësisht nga sa më sipër, çdo Palë mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje me efekte të menjëhershme, në rast të ndonjë shkeljeje përmbajtjesore të Marrëveshjes. Shkelje përmbajtjesore nënkupton shkelje të rëndë të një prej objektivave thelbësorë të kësaj marrëveshjeje.

c) Në rast se ngjarjet e forcës madhore (fatkeqësi natyrore etj.) pengojnë ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, secila Palë mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje që nga momenti kur bëhet i pamundur zbatimi i saj.

d) Në rast zgjidhjeje të parakohshme të kësaj Marrëveshjeje ose në fund të Projektit, çdo fond i pashpenzuar, i ofruar brenda kuadrit të Projektit, i kthehet SDC-së.

Neni 9

Ndryshimet dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo ndryshim ose amendim i kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim me pëlqimin e të dy Palëve.

Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin ose aplikimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje zgjidhen përmes negociatave diplomatike midis Palëve.

Neni 10

Dispozita të përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Palët nuk duhet të kërkojnë as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as në mënyrë të tërthortë përfitime të çfarëdo lloj natyre. Ato nuk duhet të pranojnë asnjë propozim të tillë. Çdo sjellje korruptuese ose e paligjshme përbën shkelje të kësaj Marrëveshjeje dhe justifikon zgjidhjen e saj, si dhe/ose marrjen e masave korrigjuese shtesë, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 11

Shtojcat

Dokumenti i Projektit (shtojca 1) është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12
Kohëzgjatja dhe efektshmëria

Kjo Marrëveshje është e vlefshme nga data 1 maj 2019 deri më 30 qershor 2023. Ajo hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të të dyja Palëve dhe përmbylljes së procedurës së brendshme ligjore, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe përfundon sapo të dyja Palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale.

Kjo Marrëveshje është hartuar në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Të dyja versionet janë origjinale dhe mbartin të njëjtën vlerë. Në rast mospërputhjesh në interpretim, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Palët e mëposhtme konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje të përpiluar në Tiranë, më 25.9.2020.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Anila Denaj
Ministre
Ministria e Financës dhe Ekonomisë

Për Qeverinë e Konfederatës Zvicerane
Adrian Maître
Ambasador
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

AFTËSI PËR PUNË (FAZA 2)
Përmbledhje e ndërhyrjes

Projekti "Aftësi për punë" synon akses më të mirë në punësim me fitim dhe të ardhura për gratë dhe burrat e rinj, duke u ofruar atyre mundësi të vlefshme trajnimi, bazuar në mënyra të reja përfshirëse të të nxënit dhe në bashkëpunimin me sektorin privat. Nga Projekti do të përfitojnë rreth 17.360 studentë dhe individë të trajnuar.

Synimi i Projektit është: Që të rejat dhe të rinjtë nga të gjitha grupimet shoqërore në Shqipëri të gjejnë punësim tërheqës dhe me fitim falë aftësive të përmirësuara.

Rezultatet që do të arrihen nga Projekti janë:

Rezultati 1: Të rejat dhe të rinjtë kanë qasje në një ofertë arsimi dhe formimi që ka **rezultat dhe është e orientuar nga tregu** në sektorë me mundësi rritje.

Rezultati 2: Sektori privat **ndërmerr përgjegjësi** për përcaktimin, ofrimin dhe financimin e AFP-së në nivel ofruesi.

Për të arritur këto rezultate, Projekti do të përqendrohet në pesë linja ndërhyrjeje, përkatësisht:

1. Marrëdhëniet me punëdhënësit dhe partnerët

Në fazën e parë Projekti S4J promovoi me sukses një qasje të re për marrëdhëniet e punëdhënësve dhe marrëdhëniet e partnerëve, duke zbatuar një qasje 1 me 1 dhe duke krijuar një rrjet përreth çdo ofruesi të AFP-së. Qasja 1 me 1 është e përshtatur për realitetet ekonomike të Shqipërisë dhe pranon mësimnxënien nga shumë përpjekje të dobëta në projekte të tjera për të

zhvilluar marrëdhënie me sektorin e organizuar privat. Ofruesit e AFP-së marrin rolin e tyre si pika kontakti në rrjet dhe në kuadrin e fazës II, ata do ta përforcojnë këtë rrjet duke e strukturuar dhe zyrtarizuar atë, si dhe duke shtuar partnerë që nuk janë shoqëri, përfshirë sektorin e organizuar privat (ku ka interes real për AFP-në), aktorët qeveritarë vendorë dhe kombëtarë, prindërit në rrjet duke zbatuar të njëjtën qasje 1 me 1. Në ato rajone ku ofruesit janë aktivë së bashku me ofrues të tjerë AFP-je për krijimin, shtrirjen dhe/ose konsolidimin e rrjeteve përkatëse. Megjithatë, qasja 1 me 1 do të zhvillohet më tej në shkallë rajonale duke krijuar platforma AFP-je që do të bashkojnë të gjitha palët përkatëse të interesit për të zhvilluar më tej AFP-në në rajon.

2. Diversifikimi i ofertës/ofrues shumëfunksionalë

S4J do të lehtësojë zhvillimin e ofertave AFP cilësore, të orientuara nga tregu, të ndjeshme ndaj gjinisë, formale dhe joformale, afatgjata dhe afatshkurtra në sektorë që kanë kërkesa të larta në rajonet ku ato shërbejnë. Këto oferta do të hartohen në bashkëpunim të ngushtë me punëdhënësit vendorë dhe rajonalë dhe zyrat e SHKP-së. Ofertat mund të përfshijnë hoteleri dhe turizëm, ndërtim, tekstile dhe TIK ose të shkojnë përtej këtyre sektorëve fillestarë kyçë të S4J-së. Ofertat hartohen bazuar në shkallët përkatëse të kualifikimit. Ato zbatojnë modalitete zhvillimi, që përfshijnë qasje me module aty ku është e përshtatshme, për të përmbushur nevojat dhe mundësitë e grupeve të synuara. Si pasojë, shkollat e AP-së që mbështeten do të kthehen në ofrues shumëfunksional, çka thelbësisht ndryshon mënyrën e tyre të funksionimit. Përveç drejtimeve, profileve apo kurseve, Projekti do të mbështesë ofruesit e AFP-së të shtojnë elementet e tjera me rëndësi në ofertat e tyre, përkatësisht përfshirjen e aftësive të sipërmarrjes dhe aftësitë e përgjithshme, si dhe veprimtaritë jashtëshkollore me rëndësi për tregun e punës.

3. Mënyra të reja të të nxënit gjithëpërfshirës dhe cilësie

Gjatë fazës së dytë do të zhvillohen më tej një sërë modelesh për zbatimin e mësimnxënies së përzier, duke u përqendruar në ato që kërkojnë qasje të lehtë në infrastrukturën e TI-së. Kjo përkthehet në një qasje të përzier mësimnxënie që i bën ofertat e AFP-së më tërheqëse, ndërkohë që qasja në to bëhet më e lehtë edhe për grupe me nevoja të veçanta. Kombinuar me trajnimet kryesuese në industri për riaftësimin e mësuesve të AFP-së, qasja e re i bën trajnimet e AFP-së edhe më të përshtatshme në tregun e punës, duke qenë se kjo qasje e re e të nxënit mbështet zhvillimin e aftësive joprofesionale, si zgjidhja e problemeve, puna në grup dhe të menduarit krijues dhe novator, që janë aftësi kyçe për arritjen e suksesit në tregun e punës, dhe që mbështesin Shqipërinë tek konkurron në shkallë ndërkombëtare. Faktorët e përzgjedhjes dhe të përjashtimit, si: vendndodhja, koha, gjinia, mosha ose faktorë të tjerë kufizues që nuk lejojnë përdorimin më të mirë të sistemit të formimit në Shqipëri, tashmë kanë më pak rëndësi, duke e bërë sistemin më gjithëpërfshirës.

4. Të nxënit e bazuar në punë, në bashkëpunim me punëdhënësit

Në kuadër të linjës së ndërhyrjes nr. 4, Projekti S4J do të vijojë me fuqizimin dhe zgjerimin e nismave të suksesshme të të nxënit, bazuar në punë, duke mbështetur partnerët shqiptarë në bashkëpunim të ngushtë me QSH-në dhe Projektin SD4E të zbatuar nga UNDP-ja për të konsoliduar, zgjeruar dhe shtrirë qasjen e zgjedhur të të nxënit, bazuar në punë, përfshirë skemat e zhvillimit gradual të aftësive, praktikat profesionale dhe zgjedhjet për stazh pune. Skemat e stazhit do të vijojnë të përmbushin standardet ndërkombëtare të cilësisë, përkatësisht kuadrin e ILO dhe BE-së për stazhin cilësor. Shoqërive do t'u sigurohet mbështetja e nevojshme, me trajnime dhe mjete, për të ofruar praktika dhe stazhe cilësore, përfshirë edhe formimin e mentorëve në shoqëri. Projekti mbështet partnerët shqiptarë për krijimin e mekanizmave dhe instrumenteve të sigurimit të cilësisë, me qëllim sigurimin e stazheve me cilësi të mirë, duke garantuar standardet e cilësisë kur qasja të jetë shtrirë përtej kontekstit të kontrolluar nga Projekti.

5. ***Administrimi i ofruesve/zhvillimi organizativ (OD)***

Rezultatet e arritura përmes linjës së ndërhyrjes 5 u mundësojnë ofruesve të AFP-së të punojnë më mirë *brenda organizatës* së tyre, të jenë të organizuar dhe të përgatitur për funksionet e reja të përcaktuara nga ligji i ri për AFP-në dhe të hartuara me mbështetjen e Projektit për partnerët ofrues në fazën e parë. Elemente të rëndësishme përfshijnë orientimin strategjik të ofruesve të AFP-së, përfshirë organizimin e tyre strategjik (strategjia e ofruesit, përbërja e bordit, funksionet dhe proceset e reja dhe të ndryshuara), funksionet e menaxhimit të bazuara në TI, të shtatë funksionet e dhëna të ashtuquajturave njësi zhvillimi dhe sigurimin e përmirësimin e cilësisë në përgjithësi për ofruesin dhe, në veçanti, duke u siguruar që cilësia të jetë shqetësim i përbashkët dhe një punë e përditshme, duke përfshirë këtu të gjithë anëtarët dhe ofruesit. Në mbështetje të funksioneve të Njësive të Zhvillimit, Projekti do të lehtësojë, gjithashtu, edhe mundësimin e lehtësirave dhe të instrumenteve novatore për hyrjen në tregun e punës në ofruesit e AFP-së, veçanërisht sa u përket masave për zhvillimin e karrierës dhe mbështetjen e nxënësit për gratë dhe burrat me nevoja të veçanta. Ato do të përfitojnë nga ndërhyrjet e hershme, me qëllim sigurimin e integrimit të tyre të suksesshëm në tregun e punës; e skemave të udhëheqjes me objekt të përcaktuar, dhe instrumente udhëzuese të thjeshta për të trajnuarit, në mënyrë që ata të zhvillojnë kompetencat e tyre dhe të gjejnë me sukses rrugëtimin e tyre drejt punësimit.

Projekti do të mbështesë kryesisht 11 ofrues në rrethet Shkodër, Lezhë, Tiranë, Berat, Vlorë dhe Elbasan. Këta ofrues përfshijnë partnerët aktualë të Projektit ("Hamdi Bushati", "Kolin Gjoka", "Gjergj Canco", "Kristo Isak", Shkollën Industriale "Pavarësia", Shkollën Tregtare dhe QFP-ja në Vlorë) dhe partnerët e rinj (Shkollën Teknike dhe Ekonomike në Tiranë, "Sali Ceka" dhe "Ali Myftiu" në Elbasan). Në QFP në Elbasan do të zbatohet një qasje më e lehtë për të testuar një qasje bazuar në shoqëri (maksimumi 3 kurse me 400 të trajnuar gjithsej).

Bazuar në supozimin se sistemi AFP do të ristrukturohet dhe se do të ngrihen Qendra Shumëfunksionale (QSHF), edhe 9 ofrues shtesë (përfshirë 3 QFP) mund të përfitojnë drejtpërsëdrejti (përkatësisht në nivelin e kapaciteteve të qendërzuara të administrimit të shkollës dhe bazuar në disa paketa të përzgjedhura transferimi) ose tërthorazi (duke mësuar e kopjuar nga ofruesit partnerë në strukturën e QSHF-ve) nga rezultatet e Projektit. Kjo e çon numrin e ofruesve të përfshirë në 20, që është thuajse gjysma e të gjithë ofruesve në vend. Ofrues të tjerë mund të përfitojnë nga reagimi në sistem, duke qenë se disa prej novacioneve mund të shtrihen në të gjithë sistemin me mbështetje specifike nga S4J nëse QSH vendos ta bëjë diçka të tillë (p.sh. sistemi i informacionit të menaxhimit të ofruesit, njësitë e zhvillimit dhe funksionet e tyre specifike, elemente të infrastrukturës NWoIL e të tjera). Në këtë rast, mbështetja e S4J do të ishte e kufizuar në ngritje kapacitetesh dhe disa masa udhëheqjeje që mbulohen në buxhetin e parashikuar.

Përfundimet kryesore në secilën fushë ndërhyrjeje:

Linja e ndërhyrjes 1 - Përfundimi kyç 1: Ofruesit e AFP-së partnerë ngrenë dhe/ose zgjerojnë dhe konsolidojnë më tej lidhjen e rrjetit 1 me 1 me sektorin privat dhe partnerë të tjerë.

Produkti 1.1: Ofruesit e AFP-së kanë mundësi të administrojnë dhe zgjerojnë rrjetet e bizneseve dhe partnerëve.

Produkti 1.2: Ofruesit e AFP-së kanë krijuar procese dhe instrument që shoqëritë dhe partnerët të japin kontribut për proceset kyçe të sigurimit të AFP-së.

Produkti 1.3: Ofruesit kanë një strategji sponsorizimi dhe kanë vënë në funksion modalitetet përkatëse.

Produkti 1.4: Pilotohet orientimi profesional për nxënësit e arsimit të përgjithshëm të detyrueshëm.

Linja e ndërhyrjes 2 - Përfundimi kyç 2: Ofruesit e AFP-së partnerë veprojnë si ofrues shumëfunksional dhe ofrojnë arsim dhe formim profesional të diversifikuar, pa dallim gjinor dhe të orientuar nga tregu i punës (si afatgjatë ashtu edhe afatshkurtër).

Produkti 2.1: Ofruesit partnerë janë të aftë të rishikojnë, përshtatin dhe zhvillojnë ofertën e tyre së bashku me rrjetin e tyre të partnerëve.

Produkti 2.2: Ofruesit e AFP-së kanë përshtatur paketat e trajnimit për të fuqizuar aftësitë sipërmarrëse dhe joprofesionale të studentëve/pjesëmarrësve në trajnim.

Produkti 2.3: Ofruesit kanë përshtatur veprimtari jashtëshkollore me në qendër studentin, që mbështesin zhvillimin e karrierës së studentëve.

Linja e ndërhyrjes 3 - Përfundimi kyç 3: Ofruesit partnerë zbatojnë mënyra të reja të nxëni dhe formimi që mëkojnë përfshirjen dhe përmbushin standardet e botës së punës.

Produkti 3.1: Partnerëve kompetentë shqiptarë u mundësohet të ofrojnë dhe të përmirësojnë më tej zhvillimin profesional në vazhdim (CPD) të mësuesve e instruktorëve të AFP-së dhe mentorëve në shoqëri, lidhur me pikëpamjet teknike dhe pedagogjike të NWoIL dhe t'i trajnojnë ata.

Produkti 3.2: Mësuesit e AFP-së dhe mentorët në shoqëri kanë procese dhe burime për zhvillimin e mëtejshëm të NWoIL në nivelin e praktikës së mësimdhënies dhe të nxënit (përmbajtje, plane mësimdhënie, instrumente).

Produkti 3.3: Infrastruktura NWoIL është e disponueshme dhe funksionale tek ofruesit e AFP-së dhe ata kanë burime investimesh, mirëmbajtjeje dhe mbështetjeje për infrastrukturat NWoIL.

Produkti 3.4: Hartohet dhe vihet në funksion një model CPD për kompetencat teknike dhe profesionale dhe trajnohen mësimdhënësit e ofruesve partnerë.

Linja e ndërhyrjes 4 - Përfundimi kyç 4: Ofruesit e AFP-së partnerë dhe biznesi hartojnë dhe ofrojnë së bashku programe WBL (stazhe dhe praktika) bazuar në kuadrin e ILO dhe BE-së për stazhin cilësor.

Produkti 4.1: Bihet dakord, vihet në funksion dhe dokumentohet një model stazhi i përshtatur për industri të ndryshme.

Produkti 4.2: Ngrihet një sistem për sigurimin e cilësisë në sistemin publik të AFP-së për WBL e bazuar në shoqëri. Autoritetet kombëtare, ofruesit dhe shoqëritë kanë kapacitete për zbatimin e tij.

Produkti 4.3: Partnerët shqiptarë kompetentë kanë aftësinë të ofrojnë dhe zhvillojnë më tej zhvillimin profesional në vazhdim të udhëheqësve në shoqëri për stazhe/WBL. Trajnohen udhëheqësit në shoqëri.

Linja e ndërhyrjes 5 - Përfundimi kyç 5: Strukturat, burimet dhe proceset e menaxhimit të ofruesve të AFP-së partnerë janë të përshtatshme dhe në punë për funksionet e reja.

Produkti 5.1: Ofruesit e AFP-së kanë mekanizma qeverisjeje (dhe instrumente) të konsoliduara që japin kontribut për cilësinë e përmirësuar të "shërbimeve".

Produkti 5.2: Njësitë e zhvillimit janë funksionale në të gjithë ofruesit e AFP-së. Ato kanë kapacitete dhe ofrojnë shërbime me cilësi të mirë.

Produkti 5.3: Pilotohen modelet e futjes në tregun e punës.

Produkti 5.4*:* Partnerëve kompetentë shqiptarë u ofrohet mundësia për të zhvilluar më tej zhvillimin profesional në vazhdim për "udhëheqjen për AFP" dhe për të trajnuar personelin e ofruesve të AFP-së për të zbatuar "udhëheqjen për AFP-në".